



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 643/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092), në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Agon Ramadani Anëtar dhe Kimete Gashi- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga (GOE) Operatori Ekonomik: "Berisha Com" sh.p.k. & "Vizion Plus" Sh.p.k. me seli në Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatin Skivjan-faza e dytë-Kontratë dy vjeçare", me nr. të prokurimit:632-22-5634-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)Komuna e Gjakovës, me datën 29.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar, ankesa e operatorit ekonomik, "Berisha Com" sh.p.k. & "Vizion Plus" Sh.p.k. me seli në Gjakovë, nr.643/22, përkitazi, me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatin Skivjan-faza e dytë - Kontratë dy vjeçare", me nr. të prokurimit:632-22-5634-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)Komuna e Gjakovës.

Mbetet në fuqi, Njoftimit mbi Ri-vendimin e Autoritetit Kontraktues, për dhënie të kontratës B58, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatin Skivjan-faza e dytë - Kontratë dy vjeçare", me nr. të prokurimit:632-22-5634-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës.

Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues të OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, të precizuar me numër dhe datë si në paragrafët paraprak të dispozitivit të këtij vendimi.

OSHP mund të ndërmarr masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092.

Konfiskohet tarifa për ankesë e (GOE), "Berisha Com" sh.p.k. & "Vizion Plus" Sh.p.k.- Gjakovë, konform nenit 31 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së dhe mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 11.11.2022 ka pranuar ankesë nga (GOE) "Berisha Com" sh.p.k. & "Vizion Plus" Sh.p.k. me seli në Gjakovë, për aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatin Skivjan-faza e dytë - Kontratë dy vjeçare", me nr. të prokurimit:632-22-5634-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovë, ankesë kjo e protokolluar nga OSHP me numër të protokollit 643/2022.

Me datë 26.10.2022 Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftim mbi Ri-vendimin për dhënie të kontratës B58 për e aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatin Skivjan-faza e dytë - Kontratë dy vjeçare", me nr. të prokurimit:632-22-5634-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovë.

Me datë 31.10.2022,(GOE)"Berisha Com"sh.p.k.&"Vizion Plus"Sh.p.k, ka bërë kërkesë për rishqyrtim lidhur Njoftimit mbi Ri-vendimin e Autoritetit kontraktues për dhënie të kontratës B58, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatin Skivjan-faza e dytë - Kontratë dy vjeçare", me nr. të prokurimit:632-22-5634-5-2-1.

Me datë 03.11.2022 Autoriteti kontraktues, refuzon si të pa pabazuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik- GOE "Berisha Com"sh.p.k. & "Vizion Plus" Sh.p.k. me seli në Gjakovë, për aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi-Asfaltimi i rrugëve në fshatin Skivjan-faza e dytë - Kontratë dy vjeçare", me nr. të prokurimit:632-22-5634-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovë.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Me datën 14.11.2022,OSHP-ë, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, i cili me datën 23 nëntor 2022, ka dorëzuar Raportin e vlerësimit:

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se i njëjti nuk e ka prezantuar deklaratat për specifikacione teknike.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmi të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK gjatë përpilimit të dosjes së tender si dokument themelor për përgatitjen e tenderëve, nuk është kërkuar tek kriteret e përzgjedhjes, si dhe Aneksi 1 të FDT-se, nuk ka pas ndonjë

specifikim teknik qe OE do te duhej te plotësonte, po ashtu tek përshkrimi i çmimeve – paramasa dhe parallogaria nuk është specifikuar se OE duhet të paraqes ndonjë deklaratë me shkrim, mirëpo specifikimi teknik është kusht i implementimit të kontratës dhe secili operatorë ekonomik është i obliguar ta respektoj. Prandaj, duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë nuk është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, OE i rekomanduar për kontrate është i pa përgjegjshëm për faktin se tek kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale, ku është kërkuar referencat dhe procesverbalet, nuk e plotëson këtë kërkesë sepse ka referenca te vitit 2017 te ndërtimit te larte, raporte për pagesa, referenca për projekte ende te pa përfunduara pra te ngela ne gjysme, po ashtu sqarimet e bëra nga OE për Referenca dhe procesverbale nuk janë sqarime konforme kërkesës siç i ka kërkuar AK-se *“Sqarimet apo raport nga autoriteti kontraktues (organi mbikëqyrës) se pse nuk është finalizuar ne tërësi projekti”*, i njëjti nuk ka arritur te ofroj raporte te lëshuara nga autoritet Kontraktuese me te cilat ka te lidhura kontrata, si dhe duhet të sqaroj se përse i janë ndërprerë ose shkëputur kontratat, si dhe i njëjti nuk ka arritur të ofroj ndonjë raport për pranim teknik te projekteve. AK-se po i bie ne kundërshtim me vendimet e tyre te marr pak dite me pare, si edhe ne kundërshtim me Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, konkretisht me nenin 69 i LPP-se, ku thuhet:

Lista e kontratave te realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale te vlerës se përcaktuar	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion te mëtejshëm	69
--	---	----

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmimeve të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 të FDT-së, si ne vijim:

Kërkesat: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Në një vlerë prej jo më pak se 240.000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60% kontrata të natyrës së ngjashme.	Evidencat: Lista e kontratave në të cilën specifikohen të gjitha punët e realizuara në 3 (tri) vitet e shkuara, duke saktësuar punët e kryera shumën e kontratës, datën e pranuesit ose certifikatën e ekzekutimit të mire të punëve – (referencë ose raport të pranimi të punëve e cila përputhet me listën e dorëzuar), në rast se Operatori Ekonomik prezanton kontrata dhe referenca me Operator Ekonomik privat atëherë Operatori Ekonomik duhet të prezanton situacionet e nënshkruara së bashku me transaksionin bankar, që përputhen me të njëjtën kontratë-referencë.
---	--

Operatoreve Ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës, N.T.SH. “Viktory Com” Sh.p.k.– Gjakovë, ka ngarkuar ne platformën elektronike e-prokurimi, listën e kontratave të nënshkruar dhe të vulosura si dhe pas sqarimeve shtesë të kërkuar nga AK–Komisioni i vlerësimit të datës 06.10.2022, OE ne fjalë ka dhënë sqarime me datë 11.10.2022 përmes platformës elektronike e-prokurim, duke ofruar letrën sqaruese dhe referencat (të gjitha të nënshkruar dhe vulosura nga projekt menaxheri -

Komuna e Gjakovës) lidhur me kontratat e prezantuar ne listën me nr. rendor. 2, 4, 6, 7 dhe 9 ne vlera: 398,134.30 €, duke plotësuar kërkesën e përcaktuar ne FDT dhe njoftimi për kontrate, si me lartë. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë nuk është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimi nr. 3

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se ne njoftimin për kontratë dhe ne dosjen e tenderit është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka se paku 15 (pesëmbëdhjetë) punëtor të mjaftueshëm si dhe te këtë staf profesional për kryerjen e projektit. Tek dëshmitë e kërkuara ka kërkuar numrin e punëtorëve te angazhuar me te dhënat ne vijim: emri, mbiemri i/e punëtorit, profesioni dhe pozicioni ne kompani. OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se i njëjti për punëtorët e kërkuar ka prezantuar kontrata me punëtorë, mirëpo nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi qe e dëshmon se i njëjti i ka enda këta punëtorë (si për shembull listat e ATK-se).

- OE N.T.SH. Viktory Com, ne dosjen e tenderit nuk e ka ofruar kontratën e punës me Ing. i Komunikacionit Uran Mulaj, ndërsa ne sqarim e ka paraqitur kontratën për inxhinierin ne fjalë, e cila kontratë mund të jetë bërë pikërisht ditën e sqarimit andaj nuk mund ta marrim për bazë.
- Ne njoftimin për kontratë dhe ne dosjen e tenderit është kërkuar një Gjeodet i licencuar.
- Ndërsa OE i rekomanduar për dhënie te kontratës ne dosjen e tenderit ka ofruar marrëveshje me një zyrë Gjeodezike. Po ashtu ne dosje ka paraqitur Suad Çmega i cili është bachelor i gjeodezie i pa licencuar dhe si i tillë nuk e plotëson kërkesën e AK-se. Gjithashtu për dosje ka ofruar Agron Dobra i cili nuk ka ofruar CV, Referenca dhe as Kontrata, si dhe për Florent Retkoceri, Bachelor te Gjeodezisë, ne dosjen e tenderit nuk ka ofruar kontrata e punës.
- Mirëpo ne sqarimin e ofruar te datës 11.10.2022, si Gjeodet ka paraqitur një z. Zef Kaza i cili nuk është ne dosjen e tenderit, andaj mendojmë se kemi të bëjmë me ndryshim material, andaj nuk e di sesi kanë mundur të pranohet si sqarim shtesë një gjeodet i cili nuk ka qenë ne dosjen e tenderit.
- Duke pasur parasysh sqarimet e paraqitura me lartë ne ankesë mund të konsiderojmë se kemi te bëjmë me favorizim të OE të rekomanduar për dhënie të kontratës dhe diskriminim apo trajtim të pa barabartë siç na është bërë si neve si OE.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmimeve të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, bazuar ne kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2 të FDT-së, si ne vijim:

Kërkesat:	Evidencat:
Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 15 (pesëmbëdhjetë) punëtorë të mjaftueshëm si dhe të ketë staf profesional për kryerjen e projektit a.) një inxhinier i diplomuar apo master i ndërtimtarisë - drejtimi konstruktiv (menaxher i kontratës dhe projektit në teren), b.) një inxhinier i diplomuar apo master i komunikacionit, c.) një gjeodet i licencuar.	Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj profesional të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë, për projekt menaxherin duhet të ofrohet dëshmi dhe vendimi për projekt menaxherin. si dhe lista e numrit të punëtorëve të angazhuar me te dhënat në vijim emri, mbiemri i e punëtorit, profesioni dhe pozicioni në kompani.

Lista e Stafit Profesional

1. Suad Çmega Gjeo Projekt SH.p.k Ing i Gjeodezis i Licensuar
2. Agron Dobra Ing i Gjeodezis i Licensuar
3. Beqe Hadergjonaj Ing i Nderimtaris
4. Uran Mulaj Ing i Komunikacionit
5. Egzon Tofaj Ing i Komunikacionit
6. Zef Kaza Ing i Gjeodezis
7. Florent Retkoceri Gjeodet i Licensuar

N.SH.T VIKTORY COM



LISTA E PUNETORVE

- | | |
|---------------------|----------------------------|
| 1. Pjeter Qerimi | Drejtor |
| 2. Jeton Qerimi | Projekt Menaxher (Arktekt) |
| 3. Mus Qerimi | Udhheheqes i Punishtes |
| 4. Nol Shemprili | Shofer/Punetor |
| 5. Driton Qerimi | Shofer |
| 6. Rajmond Qerimi | Shofer |
| 7. Vilson Qerimi | Shofer |
| 8. Jehona Qerimi | Administrat |
| 9. Rajomnda Qerimi | Administrat |
| 10. Vogel Qerimi | Shofer |
| 11. Vitor Qerimi | Shofer |
| 12. Robert Qerimi | Teknik |
| 13. Kristian Prenqi | Punetor |
| 14. Bylbyl Feraj | Punetor |
| 15. Behat Feraj | Punetor |
| 16. Gzim Feraj | Teknik |
| 17. Gjok Jakaj | Shofer Bageri |



OE i rekomanduar për dhënie të kontratës, N.T.SH “Viktory Com”, ka dorëzuar/prezantuar në platformën elektronike e-prokurim listën e punëtorëve të nënshkruar dhe vulosur po ashtu ja ka bashkangjitur edhe kontratat e punëtorëve po ashtu të nënshkruar me palëve, duke plotësuar kërkesat e FDT-së, pasi që nuk është kërkuar se lista e punëtorëve të dëshmohej përmes ATK-së.

Mirëpo, stafit profesional të prezantuar në këtë listë i ka munguar dokumentacioni, pasi që nuk ka ofruar kontratë me gjeodetën e licensuar, pasi janë prezantuar në platformën elektronike e-prokurimi diplomat për, z. Agron Dobres, z. Florent Retkoceri dhe z. Suad Çmages, po ashtu është prezantuar edhe një marrëveshje bashkëpunime me kompaninë gjeodezike “Gjeo Projekt” Shpk me numër dhe titull lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, gjithashtu në dokumentacionin e dorëzuar nuk është prezantuar kontrata, por është dorëzuar vetëm diploma për z. Uran Mulaj -Inxh. e Komunikacionit.

Duke marr për bazë këto dëshmi AK – Komisioni i vlerësimit me datë 06.10.2022 përmes letrës standarde e kërkesës për sqarim të tenderit *(ashtu siç është në raportin e vlerësimit si dhe në faqe 4, 5 dhe 6 e këtij raporti)* në pajtim me nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së në platformën elektronike e-prokurimi. Ndërsa OE N.T.SH “Viktory Com” me datën 11.10.2022 përmes platformës elektronike e-prokurim jap sqarime duke u përgjigjur në letrën standarde duke sqaruar me shkrim si dhe ka prezantuar kontratën mbi vepër me z. Uran Mulaj – Inxh. i Komunikacionit, me titull dhe numër të prokurimit për këtë aktivitet të prokurimit të nënshkruar me datë 23.06.2022, si dhe ka prezantuar/dorëzuar z. Zef Kaza – Inxhinier i Gjeodezisë duke bashkangjitur: Diplomën, Licencën, CV, dhe kontratën mbi vepër e nënshkruar me palëve me datë 23.06.2022 në emër të këtij projekti me titull dhe numër prokurimi, duke plotësuar kërkesën e FDT-se dhe me këtë veprim AK ka respektuar nenin 7 par. 1 të LPP-së, po citoj: “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”, nenin 59 par. 4 të LPP-së, ku thotë: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”.

Duke u bazuar në këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK të lartpërmendur dhe analizës së mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë nuk është i qëndrueshëm.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar në analizën e fakteve/dëshmi të dokumentuara në platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, ka respektuar nenin 7, 59,60 dhe 72 të LPP-së, dhe nenin 39.8 të RRUOPP-së, andaj Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të

behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

-Mendimi i ekspertit shqyrtues-

Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e GOE ankues të refuzohet si e pabazuar, dhe rekomandon të mbetet ne fuqi B58-njoftimit mbi vendimin AK (*vendimit për dhënie të kontratës*).

Paneli Shqyrtues mori në shqyrtim të gjitha shkresat në dispozicion të kësaj lënde, çdo parashtrësë të palëve, AK dhe OE dhe ekspertizën e ekspertit shqyrtues duke e analizuar secilin nga pretendimet e ngritura me ankesë. Në kontekstin e kësaj lënde, natyrës dhe specifikave të sajë, Paneli veçoi secilin nga pretendim ankimor dhe secilën përgjigje apo konstatim të AK dhe ekspertit shqyrtues në raport me ato duke konstatuar se:

a) Lidhur me aktivitetin e prokurimit (të precizuar si më sipër, me përshkrim, datë dhe numër) Komuna e Gjakovës, nga cilësia e autoritetit kontraktues ka aplikuar procedurë të hapur, në kuptim të përkufizimit sipas nenit 4 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.37) lidhur me nenin 33 të LPP, kurse lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 160,000,00 €;

b) Aktiviteti i prokurimit në rastin konkret, ka marrë tiparet e një çështje kontestuese në relacionet mes Ankuesit në këtë rast dhe Vendimit të AK, përkitazi me dhënien e kontratës një operatori tjetër ekonomik;

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, sipas dispozitave të neneve 98, 99, lidhur me nenin 104 dhe 105, të Ligjit të cituar dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, autorizimeve, veprimeve dhe synimeve të AK, Paneli Shqyrtues konstaton se:

Sipas vlerësimeve të ekspertit shqyrtues, pohimi i Ankuesit në këtë rast, nuk është i bazuar sepse sepse OE i rekomanduar për kontratë i përmbush të gjitha kërkesat e përshtatshmërisë. Kërkesat e përshtatshmërisë që duhet të përmbushen nga ana e një ofertuesi janë të parapara tek Dosja e Tenderit e këtij aktiviteti të prokurimit dhe njoftimit për kontratë. Këto konstatime, vlerësime dhe mendimi i ekspertit shqyrtues është i pranueshëm edhe për Panelin Shqyrtues. Në kontekstin e këtyre pohimeve, Paneli Shqyrtues konsideron se secili AK ka të drejtë që sipas autorizimeve të tija, ta japi vlerësimin e tij lidhur me kushtet e plotësuara dhe kapacitetin e një ofertuese.

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër dhe rrjedhën e procedurës, Paneli konstatoi se pretendimet kryesore mbi bazën e të cilave është ushtruar ankesa, i referohen në fakt nenit 41 (Njoftimi mbi Dhënien e Kontratës) të LPP, sipas të cilit autoriteti kontraktues ka dhënë përfundimisht një kontratë publike duke përdorur procedurat e hapura dhe duke i ndërmarrë një serë veprimesh të cilat parashihen shprehimisht me LPP, pa nevojë që të njëjtat të përshkruhen në këtë rast. Sikurse mund të kuptohet edhe nga përmbajtja e ankesës, apriori pretendimet ankimore nuk konsistojnë në faktin nëse është atakuar apo jo interesi ekonomik i Ankuesit, por ato atakojnë shkaqet dhe arsyet mbi bazën e të cilave AK, ka rekomanduar për kontratë një tjetër OE.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7, 59, 60 të LPP, të cituara në Ankesë, meqë e ka hartuar dosjen e tenderit në pajtim me kërkesat e domosdoshme, të parashikuara shprehimisht me dispozitën e nenit 27 (Dosja e Tenderit) lidhur me nenin 28 (Specifikimet teknike) të Ligjit të cituar kurse kriteret e aplikuar dhe veprimet e ndërmarra nuk karakterizohen me natyrë diskriminuese. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Në ndajshesë të lartcekurave, Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK

në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës.

Prandaj Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues

Vedat POTERQOI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komercialenë afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK-së Komuna e Gjakovës

1x1 (GOE) Operatori Ekonomik: "Berisha Com" sh.p.k. & "Vizion Plus" Sh.p.k. me seli në Gjakovë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.